



KOMUNA E PRISHTINËS
DREJTORIA E ARSIMIT

PLANI I VEPRIMIT PËR SIGURI NË SHKOLLA 2023-2026

Prishtinë,
Qershor 2023



Plani i Veprimit për Siguri në Shkolla 2023-2026

Titulli	Plani i Veprimit për Siguri në Shkolla 2023-2026
Vendi dhe data e publikimit	Prishtinë, qershor 2023
Kontribuues në Planin e Veprimit	<ul style="list-style-type: none">- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit- Policia e Kosovës- Fakulteti i Edukimit dhe i Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, dega në Kosovë- Kosova Education Center- Save the Children Kosova/o- Këshilli i Prindërve – Prishtinë- Kosovar Youth Council- Drejtorë të shkollave- Qendra për Punë Sociale- UNICEF Kosovo Programee - Jehona Oruçi- Loris Begu- Donika Xhemajli
Publikues	Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Arsimit

Përmbajtja

Shkurtesat dhe përkufizimet.....	4
Fjalë hyrëse.....	5
Pse dhe si po trajtojmë sigurinë në shkolla	6
Hartimi i Planit të Veprimit për Siguri në Shkolla	7
Përmbajtja e Planit të Veprimit për Siguri në Shkolla	8
Fushata “Çohu Kundër Dhunës”	11
ANEKS 1: Plani i Veprimit për Siguri në Shkolla 2023-2026	14
ANEKS 2: Lista e aktiviteteve në klasë për promovimin e mirëqenies dhe rritjen e sigurisë.....	21
SHTOJCA 1: Materiale ndihmëse për realizimin e Aneksit 2	28

Shkurtesat dhe përkufizimet

Shkurtesat:

PVSSH – Plani i Veprimit për Siguri në Shkolla

DKA – Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, dega në Kosovë

UP – Universiteti i Prishtinës

KEC – Kosova Education Center

KYC – Kosovar Youth Council

ShFMU – Shkollë/a Filllore dhe e Mesme e Ulët

ShML – Shkollë/a e Mesme e Lartë

KDSh – Këshilli Drejtues i Shkollës

KP – Këshilli i Prindërve

KN – Këshilli i Nxënësve

Përkufizimet:

Siguri – gjendje pa ndonjë rrezik a të keqe të papritur; gjendje që mundëson zhvillimin e qëndrueshëm të nxënësve pa ekspozim ndaj rreziqeve dhe/ose dukurive negative

Mirëqenie – gjendja e të qenit/ndjerit mirë, përshtatshëm, shëndetshëm ose i lumtur

Institucione edukativo-arsimore – të gjitha institucionet të cilat ofrojnë shërbimin e edukimit, kujdesit dhe arsimit ndaj fëmijës; kopshtet, shkollat

Komunitet i shkollës/shkollor – të gjitha palët e përfshira drejtpërdrejt apo jo drejtpërdrejt në institucionet edukativo-arsimore; nxënësit, prindërit dhe stafi arsimor

Objektiv – qëllimi a synimi që duam të arrijmë; qëllimi i përgjithshëm që duam të arrijmë përmes përmbushjes së disa kushteve dhe realizimit të disa aktiviteteve

Dhunë – ushtrimi i forcës a shtrëngimi me mjete e me mënyra të vrazhda ndaj dikujt (në këtë rast ndaj anëtarëve të komunitetit shkollor); detyrim a shtypje me anë të forcës

Bullizëm – tendenca për të lënduar, frikësuar ose detyruar (dikë që perceptohet si i pambrojtur)

Fjalë hyrëse



Të dashur lexues,

Ky dokument është hartuar me qëllim të shtjellimit narrativ të Planit të Veprimit për Siguri në Shkolla 2023-2026, të hartuar nga Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës. Dokumenti trajton temën e sigurisë në shkolla me fokus te dhuna dhe çështjet sociale të cilat ndikojnë në ambientin dhe klimën brenda të gjitha institucioneve edukative, arsimore dhe aftësuese në Komunën e Prishtinës.

Përgjatë vitit 2022, Drejtoria e Arsimit ka punuar vazhdimisht për të gjetur mënyra efektive dhe konkrete për të përmirësuar kushtet e sigurisë brenda shkollave, duke përfshirë infrastrukturën dhe mekanizmat përbrenda tyre. Përmes këtij dokumenti, Drejtoria synon të paraqes para nxënësve, prindërve, stafit arsimor dhe të gjithë publikut angazhimin dhe planin e saj për t'i bërë shkollat hapësira të sigurt ku nxënësit mund të zhvillohen dhe të kenë sukses, pa dhunë, bullizëm apo çfarëdo ekspozimi ndaj dukurive negative që mund të hasin. Kjo mund të realizohet vetëm përmes fuqizimit të bashkëpunimit mes të gjitha grupeve të interesit me qasje transparente dhe efikase.

PVSSh synon të ruajë mirëqenien e secilit anëtar të komunitetit të shkollës. Kjo qasje siguron respektimin e të drejtave të fëmijëve për zhvillim të qëndrueshëm, përkatësisht arsimim dhe edukim të sigurt. Krahas kësaj, rëndësi të veçantë ka rritja e kapaciteteve institucionale për të aplikuar përgjegjësi dhe llogaridhënie profesionale dhe menaxheriale në çështjet e sigurisë.

Fëmijët tanë janë të ekspozuar ndaj informatave të pafiltruara të cila ndikojnë në zhvillimin psikologjik dhe emocional dhe mënyrën se si ata reagojnë. Rrjedhimisht, shkollat, si institucione edukativo-arsimore dhe aftësuese kanë për detyrë jo vetëm zbatimin e kurrikulës dhe arsimimin, por edhe kultivimin e qytetarisë të përgjegjshme dhe aktive.

Ne vlerësojmë se transparenca, etika dhe profesionalizmi janë esenciale për trajtimin e kësaj çështjeje. Kjo përfshin edhe respektimin e privatësisë së fëmijëve dhe raportimin e drejtë mediatik. Drejtoria e Arsimit fton të gjithë komunitetin shkollor dhe palët e përfshira t'i bashkohen kauzës dhe përpjekjeve tona për siguri të qëndrueshme duke trajtuar atë si prioritet. Vetëm së bashku ne mund të përmirësojmë shkollat tona dhe rrisim sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve tanë.

Besianë Musmurati

Drejtore e Arsimit, Komuna e Prishtinës

Pse dhe si po trajtojmë sigurinë në shkolla

Pse?

Sipas studimeve, hulumtimeve dhe anketave të shumta, shkollat në Komunën e Prishtinës nuk ofrojnë ambient e as sistem mjaftueshëm të sigurt për zhvillimin e qëndrueshëm të nxënësve dhe stafit arsimor. Gjatë vizitave të ndryshme në shkolla nga Drejtorja e Arsimit, znj. Musmurati dhe zyrtarë tjerë nga DKA, nxënësit, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave kanë shprehur vazhdimisht se siguria në shkolla është një problem thelbësor në Prishtinë.

Sipas raportit të OSBE-së dhe Policisë së Kosovës për sigurinë në shkollat e Prishtinës, rreth 23.5% e nxënësve të klasave 6-12 deklarojnë se nuk ndihen aq të sigurt apo të pasigurt në shkollat e tyre.

Sipas raportit, aspektet të cilat duken se cenojnë më shumë sigurinë në shkolla vlerësohen të jenë vizitorët e pakontrolluar në hapësirat e shkollës, përleshjet fizike, vandalizimet, ngacmimet gjatë rrugës për në shkollë/shtëpi, si dhe në masë të caktuar vlerësohet të jetë edhe mundësia për vjedhje të pasurisë të nxënësve.

Nxënësit e klasave 1-5 vlerësojnë se “ngatërresat ndërmjet nxënësve (në formë të sharjeve e ofendimeve)” poashtu janë çështje që ndikojnë dukshëm sigurinë e tyre në shkollë.

Duke marrë parasysh të gjithë indikatorët shqetësues të lartcekur, Komuna e Prishtinës ka vendosur që sigurinë e nxënësve ta bëjë prioritet dhe ta trajtojë atë me urgjencë.

Si?

Ne po trajtojmë çështjen e sigurisë me seriozitetin më të lartë. Kjo nënkupton se për secilin veprim që ndërmarrim të gjithë janë të përfshirë – nxënësit, prindërit, stafi arsimor dhe ekspertët. Duke u bazuar në opinionet, sugjerimet dhe të dhënat nga ta, ne kemi hartuar Planin për Siguri në Shkolla 2023-2026, i cili parasheh veprimet që do të ndërmerren këtë kohështrirjen.

Ky plan nuk është një dokument statik i pandryshueshëm, përkundrazi, ai është një dokument që është vazhdimisht në zhvillim. Në këtë frymë, DKA do të vazhdojë ndërveprimin me të gjithë grupet e interesit në shkolla, në mënyrë që vazhdimisht të marrë informatë kthyesë për ndryshimin dhe përmirësimin e këtij Plani.

Hartimi i Planit të Veprimit për Siguri në Shkolla 2023-2026

Në bazë të gjetjeve të hulumtimit të Komunës së Prishtinës, Policisë së Kosovës dhe OSBE-së (Gallopini, B. (2021) *Siguria në shkollat e Komunës së Prishtinës*. Komuna e Prishtinës, Prishtinë), bisedave me komunitetin shkollor dhe vizitave në terren, Drejtorja e Arsimit mori nismë për hartimin e Planit të Veprimit për Siguri në Shkolla. Grupi punues u përbë nga: zyrtarë të DKA-së, zyrtarë të MASHTI, zyrtarë të Policisë së Kosovës, profesorë të Fakultetit të Edukimit – UP, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të KEC, përfaqësues të Save the Children Kosova/o, përfaqësues të KP – Prishtinë, përfaqësues të KYC-së, psikologë shkollor, ShFMU “Dardania”, ShFMU “Elena Gjika”, ShML “Eqrem Çabej”, ShFMU “Faik Konica”, ShFMU “Hilmi Rakovica”, ShFMU “Qamil Batalli”, ShFMU “Shkëndija” dhe ShML “28 Nëntori”.

Ky grup punues gjatë vitit 2022 ka mbajtur disa takime, ku në ekipe të ndara është punuar në fusha të ndryshme. Rrjedhimisht, nga këto ekipe janë përcaktuar objektivat dhe nënobjektivat e PVSSh, me qasje shumëdimensionale. Për objektiva janë planifikuar aktivitetet konkrete përkatëse, janë ndarë përgjegjësitë dhe janë përcaktuar kostot financiare.

Përveç aktiviteteve të planifikuara, PVSSh-së i bashkohet edhe një aneks i cili përmban një udhërrëfyes për shkollat se si të parandalojnë, identifikojnë, raportojnë dhe trajtojnë dhunën. Këta komponentë trajtohen me punëtori ndërgjegjësuere për nxënësit dhe mësime të mësimdhënësit.

PVSSh është në harmoni të plotë me protokollet dhe udhëzimet administrative të cilat janë të rregulluara konform legjislacionit në fuqi dhe i njëjti konsiderohet të jetë i pranueshëm dhe aplikueshëm në të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Prishtinës.

Përmbajtja e Planit të Veprimit për Siguri në Shkolla

Duke pasur parasysh që ofrimi i sigurisë në shkolla garantohet në disa dimensione, Plani i Veprimit për Siguri në Shkolla ndahet në tri (3) objektiva, shtatë (7) nënobjektiva dhe 48 aktivitete. Objektivat kryesore të Planit janë: 1. Infrastrukturë shkollore që garanton siguri; 2. Përmirësimi i klimës së shkollës; dhe 3. Rritja e sigurisë nga dhe deri në shkollë. Kostoja vjetore e zbatimit të të gjitha aktiviteteve parashihet të jetë 1,571,100 Euro dhe do të mbulohet nga Komuna e Prishtinës, donatorë të ndryshëm, shkollat si dhe OJQ-të që merren me fushën e sigurisë.

Objektivi 1: Infrastrukturë shkollore që garanton siguri

Shkollat në Komunën e Prishtinës nuk janë të pajisura me infrastrukturë të mjaftueshme që garanton siguri për nxënësit, stafin dhe komunitetin. Rrjedhimisht, për ta siguruar këtë infrastrukturë që reflekton ambient miqësor për komunitetin shkollor, të gjitha shkollat në Prishtinë do të pajisen me kamera të sigurisë, ndriçim efektiv, rrethoja të oborrit dhe sigurim fizik. Gjithashtu, për të garantuar gjithëpërfshirje të sigurt të personave me aftësi të kufizuara, ne synojmë të vendosim pjerrina dhe/ose ashensorë në të gjitha institucionet shkollore.

Duke qenë se shkollat mund t'i ekspozohen rasteve emergjente, planifikojmë që t'i pajisim shkollat me kuti të ndihmës së parë, shkallë emergjente, sinjalizim dhe hartë të evakuimit. Secila shkollë do të hartojë planet e veta të emergjencës dhe me përkrahjen e institucioneve të sigurisë do të bëjnë simulime të tyre.

Disa nga aktivitetet e këtij Objektivit përfshijnë:

- Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas indikatorëve të sigurisë për të gjitha IEAA;
- Vendosja e kamerave të sigurisë në të gjitha IEAA;
- Ndriçimi i brendshëm dhe i jashtëm i të gjitha IEAA;
- Rrethoja të sigurt të oborreve në të gjitha IEAA;
- Vendosja e sistemeve të sigurimit në të gjitha IEAA;
- Vendosja e pjerrinave apo lifteve për qasje të personave me aftësi të kufizuara;
- Studimi i fizibilitetit për ushqim të shëndetshëm dhe krijimin e bufesë në shkolla;
- Përcaktimi i kohës së pushimit të gjatë jo njëherësh;
- Pajisja e shkollave me pako të ndihmës së parë;
- Vendosja e shkallëve emergjente në shkolla;
- Zhvillimi i planit për emergjencë në çdo shkollë;
- Trajnimi i dy personave përgjegjës në shkollë për menaxhim të gjendjes emergjente.

Këto aktivitete që do të ndërmerren nga Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Emergjencave dhe Sigurisë, Policia e Kosovës dhe Asociacioni i Drejtorëve të Prishtinës prekin koston vjetore prej 488,500 Euro. Këto mjete do të ndahen nga Komuna e Prishtinës dhe drejtoritë e saj përkatëse.

Objektivi 2: Përmirësimi i klimës së shkollës

Duke respektuar mirëqenien e secilit dhe vlerësuar rëndësinë e zhvillimit të një kulture gjithëpërfshirëse, diverse, tolerante dhe bashkëpunuese dhe duke respektuar të drejtat e anëtarëve të komunitetit të shkollës, objektivi i dytë ka fokus përmirësimin e klimës së shkollës. Objektivi në vetvete parasheh që përmes rritjes së numrit të psikologëve, zhvillimit profesional të vazhdueshëm të mësimitdhënësve, aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe funksionalizimit të Ekipit të Sigurisë dhe Ekipit të Ndërmjetësimit të parandalojë, ndërgjegjësojë dhe ngritë kapacitetet e shkollës. Përmes aktiviteteve gjithëpërfshirëse ndërkurrikulare dhe ekstrakurrikulare, synohet të promovohet klima pozitive në shkollë.

Në mënyrë që të përmirësohet klima dhe ambienti i shkollës përmes kultivimit të vlerave pozitive, është esenciale që raportimi dhe reagimi në rastet e dhunës të bëhet në kohë reale. Ngritja e kapaciteteve menaxheriale dhe profesionale të shkollave përmes fuqizimit të Asociacionit të Drejtorëve të Prishtinës do të kontribuojë në qasjen e sinkronizuar ndaj këtyre dukurive. Për të pasur një qeverisje funksionale dhe efektive në kuadër të çështjeve të sigurisë është e rëndësishme që të fuqizohet bashkëpunimi mes organeve të shkollës (KDSH, KP, KN) duke organizuar takime të rregullta me komunitetin.

Disa nga aktivitetet e këtij Objekti përfshijnë:

- Rritja e numrit të psikologëve në shkollë dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i tyre;
- Zhvillimi i aktiviteteve parandaluese për nxënësit (shkathtësive për zgjidhjen e problemeve në mënyrë paqësore, shkathtësitë e komunikimit, shkathtësitë e negociimit, etj.);
- Aplikimi i uniformave të nxënësve në shkollë;
- Zhvillimi profesional i vazhdueshëm për mësimitdhënës në fushën e sigurisë dhe mirëqenies në shkollë;
- Krijimi dhe funksionalizimi i grupeve të ndërmjetësimit në shkollë;
- Aktivitete ndërgjegjësuere për të gjitha format e dhunës;
- Krijimi i ekipit të sigurisë dhe mirëqenies në shkollë dhe DKA;
- Krijimi i Kodit të Etikës për çdo IEAA;
- Mbajtja dhe promovimi i orës së kujdestarisë;
- Krijimi këndeve të ndryshme atraktive në shkollë;
- Zhvillimi i Procedurave Standarde të Operimit për parandalim, intervenim, reagim;
- Paraqitja e rasteve në Modulin e Incidentit SMIA,
- Gjenerimi i statistikave periodike dhe shfrytëzimi i tyre për orientim të veprimeve brenda shkollës;
- Organizimi i takimeve të shkollës me komunitetin, prindërit dhe Policinë;

- Funkcionalizimi dhe fuqizimi i KDSH, KP, KN në çdo shkollë;
- Fuqizimi i Asociacionit të Drejtorëve, Këshillit të Nxënësve dhe të Prindërve;
- Rregullore për përdorim të telefonave nga nxënësit dhe mësimdhënësit.

Kostoja vjetore për realizimin e këtyre aktiviteteve do të jetë rreth 617,600 Euro. Mjetet do të ndahen nga Komuna e Prishtinës dhe drejtoritë përkatëse, të hyrat vetanake të shkollave, dhe donatorë-të ndryshëm.

Objektivi 3: Rritja e sigurisë nga dhe deri në shkollë

Siguria në ambientin shkollor ndikohet nga disa faktorë duke përfshirë sigurinë e përgjithshme në Kryeqytet. Rrjedhimisht dukuritë dhe situatat të cilave nxënësit mund t'i ekspozohen gjatë rrugës nga shtëpia për në shkollë barten brenda shkollës. Për të përmirësuar këtë gjendje të sigurisë së përgjithshme në rrugë, plani parasheh caktimin e kriterëve për transportin e nxënësve në shkolla, vendosjen e mekanizmave mbrojtës në rrugët para shkollave, inspektimin e lokaleve afër shkollave dhe mirëmbajtjen e ndriçimit në rrugët para shkollave.

Disa prej aktiviteteve kyçe në këtë Objektiv përfshijnë:

- Caktimi i kriterëve për transportin e nxënësve në shkolla si dhe krijimin e udhëzuesit për prindër për transport privat të nxënësve;
- Shenjzimi i rrugëve pranë shkollave;
- Inspektimi i lokaleve afër shkollave;
- Patrullimi nga njësitë policore në afërsi të shkollave;
- Mirëmbajtja e ndriçimit të rrugëve pranë shkollave;
- Zgjerimi i projektit “Rrugët për fëmijët”;
- Angazhimi i policëve të pensionuar për të ndihmuar fëmijët të kalojnë rrugën.

Kostoja vjetore për realizimin e objektivit së tretë do të jetë rreth 465,000 Euro. Mjetet do të ndahen nga Komuna e Prishtinës dhe drejtoritë përkatëse, të hyrat vetanake të shkollave, dhe donatorë të ndryshëm. Sa i përket këtij objektivi, duhet koordinim i ngushtë me Inspektoratin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si dhe Policinë e Kosovës.

Fushata “Çohu Kundër Dhunës”



Çohu Kundër Dhunës është fushatë e cila është nisur dhe ideuar nga vetë nxënësit, duke u bërë kështu fushata e parë e natyrës së tillë në Prishtinë. Ideja e nxënësve gjeti mbështetjen e DKA-së dhe institucioneve edukativo-arsimore në mënyrë që dhuna të mos jetë pjesë e përditshmërisë dhe të trajtohet me seriozitet. Fushata kishte për qëllim trajtimin e dhunës dhe bullizmit nga këndvështrimi i fëmijëve. Përmes punëtorive të realizuara gjatë fushatës, ne morëm informata kthyesë në raport me qasjen e nxënësve në parandalim, identifikim, raportim dhe trajtim të dhunës. Rrjedhimisht, Çohu Kundër Dhunës u përshtat me strategjinë tonë për siguri në shkolla.

Fushatës iu bashkuan 15 shkolla të Komunës së Prishtinës, të cilat mbajtën takime dhe organizuan punëtori nëpër shkollat e tyre. Përgjegjës për këto takime dhe punëtori ishin Këshillat e Nxënësve dhe mësimdhënësit lehtësues. Punëtoritë kishin për qëllim të siguronin gjetje sipas këndvështrimeve të nxënësve se çfarë rrugë komunikimi dhe mekanizma ka nevojë shkolla për parandalim të dhunës. Shkollat pjesëmarrëse ishin: ShFMU “Ali Kelmendi”, ShFMU “Asim Vokshi”, ShFMU “Ismail Qemali”, ShFMU “Elena Gjika”, ShFMU “E Gjelbër”, ShFMU “Emin Duraku”, ShFMU “Faik Konica”, ShFMU “Hasan Prishtina”, ShFMU “Iliria”, ShFMU “Mehmet Gjevori”, ShFMU “Meto Bajraktari”, ShFMU “Naim Frashëri”, ShFMU “Nazim Gafurri” dhe ShFMU “Xhemail Mustafa”.

Ideja ishte që përmes kësaj fushate të përfshihen sa më shumë nxënës në mënyrë që për një kohë të caktuar të mendojmë dhe komunikojmë për dhunën si dukuri e përditshme.

Të gjeturat e dala nga punëtoritë sipas moduleve kanë të bëjnë kryesisht me pengesat në raportim, pasigurinë e nxënësve, problemet me identifikim dhe metodat jofunksionale në trajtim të dhunës. Identifikimi i rasteve sipas gjetjeve ndihmon drejtpërdrejt në parandalim të dhunës. Në mungesë të qasjes ndaj rasteve të dhunës, ndërjegjësimit, ndjeshmërisë të situatave të të gjitha palëve të përfshira për identifikim të dhunës me kohë, në shkollë vërehet se është e nevojshme të punohet në ndërtimin e raporteve të besueshme dhe profesionale në mes nxënësve, mësimdhënësve dhe menaxhmentit. Për qasje profesionale në identifikim të dhunës konsiderohet se personeli arsimor duhet të zhvillohet në këtë drejtim.

Gjetjet tjera dëshmojnë arsyet pse nxënësit hezitojnë të raportojnë dhunën. Për ta përmirësuar gjendjen, ata dolën me rekomandime për të ngritur nivelin e vetëdijes individuale, grupore dhe institucionale në lidhje me këtë çështje. Ata mendojnë se arsyet që pengojnë raportimin janë: frika se bullizuesi do të lëndojë/bullizojë/dhunojë raportuesin; humbja e shoqërisë – nxënësit mendojnë se në rastet kur raportohet bullizmi, raportuesi mund të etiketohet si “spion” dhe si pasojë e kësaj do të lihet anash

nga shoqëria; ndikimi i rrjeteve sociale dhe mediave bën që raportuesi të ndjejë pasiguri ndaj ekspozimit mediatik.

Vërehet se fushata të ngjashme si kjo, ku nxënësit shprehen lirshëm për dhunën janë të rëndësishme dhe duhen të realizohen në vazhdimësi, si instrumente për ndërgjegjësim të nxënësve në komunikim dhe raportim të dhunës. Shkolla obligohet të ngrejë mekanizmat për raportim të dhunës.

Të gjeturat nga moduli tregojnë se shkollat akoma nuk kanë mekanizma funksional dhe të mjaftueshëm për trajtimin e dhunës. Aktualisht, shumica e tyre detyrimisht trajtojnë vetëm rastet e dhunës fizike, do të thotë kur situatat e dhunës eskalojnë dhe trajtimi i tyre është i pashmangshëm. Kjo qasje e shkollave, përjashton trajtimin e formave të tjera të dhunës. Nxënësit treguan se dhuna nëpër shkolla trajtohet me urgjencë, jo mjaftueshëm dhe nuk ka konsistencë. Ata nuk janë të kënaqur me trajtimin e dhunës nëpër Komisionet Disiplinore, për shkak se aty në shumë raste anashkalohen të gjitha këndvështrimet e nxënësve të përfshirë. Andaj, shkollat do të duhej të ndërtonin dhe funksionalizonin ekipe të qëndrueshme për trajtimin e dhunës, në të cilat do të kishte gjithëpërfshirje, besueshmëri, profesionalizëm dhe konsistencë.

Të dalat e fushatës, të cilat janë shndërruar në instrumente për trajtimin e çështjes së dhunës, gjinden në Aneksin 2 të këtij dokumenti, ndërsa aktivitetet ndërgjegjësuere në Aneksin 3.

ANEKS 1: Plani i Veprimit për Siguri në Shkolla 2023-2026

Objektivi 1: Infrastrukturë shkollore që garanton siguri							
Nën-objektivi 1.1: Infrastrukturë e sigurt fizike							
Nr.	Aktivitetet	Afati kohor	Institucioni përgjegjës	Kostoja financiare vjetore vjetore	Burimet financiare	Institucionet mbështetëse	Indikatorët matës
1.1.1	Vlerësimi i gjendjes aktuale krahas indikatorëve të sigurisë për të gjitha IEAA	2023	DKA, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	€0.00	Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Shkollat	Studimi i realizuar për të gjitha IEAA
1.1.2	Vendosja e kamerave të sigurisë në të gjitha IEAA	2023-2024	DKA, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	€50,000.00	DKA, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	Shkollat	Kamera në ccdo IEAA
1.1.3	Ndriçimi i brendshëm dhe i jashtëm i të gjitha IEAA	2023-2026	DKA	€70,000.00	DKA	Shkollat	Ndricim funksional në ccdo IEAA
1.1.4	Rrethoja të sigurta të oborreve në të gjitha IEAA	2023-2026	DKA	€75,000.00	DKA, Drejtoria e shërbimeve publike	Shkollat	Rrethoja funksionale në ccdo IEAA
1.1.5	Vendosja e sistemeve të sigurimit në të gjitha IEAA	2023-2026	DKA	€80,000.00	DKA	Shkollat	Kontrata e lidhur me kompaninë e sigurimit
1.1.6	Vendosja e pjerrinave apo lifteve për qasje të personave me aftësi të kufizuara	2024-2026	DKA, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	€70,000.00	DKA	Drejtoria e shërbimeve publike;	Qasje për persona me aftësi të kufizuara në ccdo IEAA
1.1.8	Studimi i fizibilitetit për ushqim të shëndetshëm dhe krijimin e byfësë në shkolla	2023-2024	DKA	€6,500.00	DKA, Donatorë	Donatorë, OJQ	Prodhimi i raportit të studimit
1.1.9	Përcaktimi i kohës së pushimit të gjatë jo njëherësh	2023	Asociacioni i drejtorëve të Shkollave	€0.00	DKA	Këshilli i Prindërve të Komunës së Prishtinës	Orari i pushimit të gjatë për shkolla

Nën-objektivi 1.2: Menaxhimi i duhur i rasteve emergjente

Nr.	Aktivitetet	Afati kohor	Institucioni përgjegjës	Kostoja financiare vjetore	Burimet financiare	Institucionet mbështetëse	Indikatorët matës
1.2.1	Pajisja e shkollave me pako të ndihmës së parë	2024-2025	DKA	€32,000.00	DKA, Drejtoria e shëndetësisë	Drejtoria e shëndetësisë	IEAA të pajisura me pako të ndihmës së parë
1.2.2	Vendosja e shkallëve emergjente në shkolla	2024-2026	DKA, Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	€90,000.00	DKA, Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	Drejtoria pwr Shwrbime Publike	IEAA të pajisura me shkallë emergjente
1.2.4	Zhvillimi i planit për emergjencë në çdo shkollë	2023-2024	DKA, Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca, Asociacioni i Drejtoreve te shkollave	€5,000.00	Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca, OSBE, Policia e Kosovës	Plan për emergjencë për cdo IEAA
1.2.5	Trajnimi i dy personave përgjegjës në shkollë për menaxhim të gjendjes emergjente	2024-2026	Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	€10,000.00	Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	Njesia profesionale për zjarrëfikje dhe shpëtim, Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca, Policia e Kosovës	Numri i trajnimeve të mbajtura
1.2.6	Stervitje dhe simulim	2024-2026	Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca, DKA, Policia	€0.00	Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca	Policia e Kosovës, MPB, Sherbimet Emergjente	Lista e kontrollit

Objektivi 2: Përmirësimi i klimës së shkollës

Nën objektivi 2.1 Parandalimi i dukurive negative, vetëdijësimi dhe ngritja e kapaciteteve

Nr.	Aktivitetet	Afati kohor	Institucioni përgjegjës	Kostoja financiare vjetore	Burimet financiare	Institucionet mbështetëse	Indikatorët matës
2.1.1	Rritja e numrit të psikologeve në shkollë dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i tyre	2023-2026	DKA	€20,900.00	DKA	Departamenti i Psikologjisë së Universitetit të Prishtinës, Shoqata e Psikologëve Shkollorë, Donatorë, OJQ	Lista e të punësuarve dhe plani i zhvillimit profesional
2.1.2	Zhvillimi i aktiviteteve parandaluese për nxënësit (shkathësive për zgjidhjen e problemeve në mënyrë paqësore, shkathësitë e komunimit, shkathësitë e negociimit etj)	2023-2026	Shkollat, DKA, psikologët shkollorë	€19,200.00	Të hyrat vetanake të shkollës; DKA. Donatorë	MASHTI (sektori për të drejtat e njeriut), MPB (Policia), QPS, OJQ	Plani i aktiviteteve në nivel komunal
2.1.3	Aplikimi i uniformave të nxënësve në shkollë	2023-2024	Shkollat	NA	Të hyrat vetanake të shkollës; Prinderit	DKA	Cdo shkollë me uniformë
2.1.4	Zhvillimi profesional i vazhdueshëm për mësuesin në fushën e sigurisë dhe mirëqenies në shkollë	2023-2026	DKA, MASHTI,	€150,000.00	DKA, MASHTI, Donatorët	Donatorë, OJQ, MASHTI (sektori për të drejtat e njeriut)	Nr i trajnimeve të mbajtura
2.1.5	Krijimi dhe funksionalizimi i grupeve të ndërmjetësimit në shkollë	2023-2025	Shkollat	€0.00	-	Donatorë, OJQ, Psikologët shkollorë	Lista e kontrollit të grupeve të ndërmjetësimit
2.1.6	Aktivitetet vetëdijësuese për të gjitha format e dhunës	2023-2026	DKA,	€50,000.00	Donatorët, OJQ	MASHTI (Sektori për të drejtat e njeriut), QPS, Policia e Kosovës, Donatorë	Plani i aktiviteteve në nivel komunal

2.1.7	Krijimi i ekipit të sigurisë dhe mirëqenies në shkolla	2023-2025	Shkolla	€0.00	Shkolla	Zyra apo personat përgjegjës për siguri në nivel të Komunës	Vendimi me personat përgjegjës dhe përkrahjen e detyrave
2.1.8	Krijimi i ekipit të sigurisë dhe mirëqenies në DKA	2023	DKA	€0.00	DKA	QPS, Departamenti i Psikologjisë, Donatorë, shkollat	Personeli i punësuar apo i alokuar për këtë aktivitet
Nën objektivi 2.2 Promovimi i klimës pozitive në shkollë							
Nr.	Aktivitetet	Afati kohor	Institucioni përgjegjës	Kostoja financiare vjetore	Burimet financiare	Institucionet mbështetëse	Indikatorët matës
2.2.1	Krijimi i Kodit të Etikës për cdo IEAA	2023-2026	Asociacioni i Drejtorëve, shkollat, DKA	€2,500.00	DKA	Departamenti i Psikologjisë dhe Fakulteti i Edukimit	Kodi i Etikës për cdo IEAA
2.2.2	Mbajtja dhe promovimi i orës së kujdestarisë	2023-2026	Shkolla	€0.00	-	DKA	Plani vjetor për orët e kujdestarisë
2.2.3	Krijimi këndeve të ndryshme atraktive në shkolla	2023-2026	Shkolla, DKA	€320,000.00	Të hyrat vetanake, DKA, donatorët, Drejtoria e shërbimeve publike	DKA, Donatorë, OJQ	Kënde miqësore në cdo IEAA
Nën objektivi 2.3 Intervenimi, reagimi dhe raportimi i rasteve të dhunës							
Nr.	Aktivitetet	Afati kohor	Institucioni përgjegjës	Kostoja financiare vjetore	Burimet financiare	Institucionet mbështetëse	Indikatorët matës
2.3.1	Zhvillimi i Procedurave Standarde të Operimit për parandalim, intervenim, reagim	2023-2024	Asociacioni i drejtorëve të Shkollave; DKA	€0.00	-	Policia; Save the Children	Udhëzues i publikuar për cdo IEAA
2.3.2	Paraqitja e rasteve ne Modulin e Incidentit SMIA	2023-2026	Shkolla	€0.00	-	DKA, MASHTI	Raportimi I rasteve (EMIS - Smia)

2.3.3	Gjenerimi i statistikave periodike dhe shfrytëzimi i tyre për orientim të veprimeve brenda shkollës	2023-2026	Shkolla	€0.00	-	DKA	Databaza e raportimit të rasteve
2.3.4	Raportimi 3 mujor për cdo IEAA për rastet e dhunës në shkollë	2023-2026	Shkolla	€0.00	-	DKA	Raporte tremujore të dorëzuara në DKA tek ekipi për siguri
2.3.5	Organizimi i takimeve të shkollës me komunitetin, prindërit dhe Policinë	2023-2026	Shkolla, Këshilli i Prindërve	€0.00	-	DKA, Policia	Plani i takimeve dhe numri i takimeve të realizuara
2.3.6	Trajnimi i stafit të shkollës për rritjen e sigurisë në shkollë	2023-2026	DKA, Shkolla	€25,000.00	DKA, MASHTi	MASHTi, Donatorw, OJQ	Numri i stafit të trajnuar

Nën objektivi 2.4 Përmirësimi i qeverisjes së shkollës

Nr.	Aktivitetet	Afati kohor	Institucioni përgjegjës	Kostoja financiare vjetore	Burimet financiare	Institucione të mbështetëse	Indikatorët matës
2.4.1	Funksionalizimi dhe fuqizimi i KDSH, KP, KN në cdo shkollë	cdo vit në tetor/nëntor	Shkolla	€0.00	-	DKA, Këshilli i Nxënësve, Këshilli i Prindërve	Vendimet e themelimeve për secilin grup
2.4.2	Takime mujore në mes të DKA dhe drejtorive të shkollave si mekanizem për komunikim dhe ndarje të përvojave	2023-2026	DKA	€0.00	-	Asociacioni i drejtorëve	Ekstrakti i Procesverbaleve
2.4.3	Fuqizimi i asociacionit të drejtorëve	2023-2024	DKA; Asociacioni i Drejtorëve	€10,000.00	DKA	-	Plani i veprimit për një vit pune

2.4.4	Fuqizimi i Këshillit të Nxënësve	2023-2026	Shkolla	€20,000.00	DKA	DKA, Këshilli i Nxënësve, Këshilli i Prindërve	Numri i aktiviteteve të realizuara
2.4.5	Rregullore për përdorim të telefonëve nga nxënësit dhe mësimdhënësit	2023-2024	Shkolla	€0.00	MASHTI	DKA, MASHTI	Rregullorja e publikuar

Objektivi 3: Rritja e sigurisë nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas

Nr.	Aktivitetet	Afati kohor	Institucioni përgjegjës	Kostoja financiare	Burimet financiare	Institucione të mbështetëse	Indikatorët matës
3.1	Caktimi i kriterëve për transportin e nxënësve në shkollë si dhe krijimin e udhëzuesit për prindër për transport privat të nxënësve	2023-2024	Asociacioni i Drejtorëve të Shkollave	€0.00	-	DKA	Kriteret e publikuara në uebfaqe të komunës dhe në kontratat e prokurimit publik për transport
3.2	Shenjëzimi i rrugëve pranë shkollave	2023 - 2024	Drejtoria e shërbimeve publike	€65,000.00	Drejtoria e shërbimeve publike	DKA	Cdo IEAA me rrugë të shenjëzuara
3.3	Inspektimi i lokaleve afër shkollave	2023-2026	Inspektoriati i Komunës, DKA, Inspektoriati i Tregut, Policia	€0.00	-	Shkollat	Numri i inspektimeve në vit
3.4	Patrollimi nga njësitë policore në afërsi të shkollave	2023-2025	Policia e Kosovës, Shkolla, Komiteti Lokal për Siguri Publike, QPS	€0.00	-	Policia, QPS, Shkollat	Numri i vizitave në shkollë dhe afër tyre

ANKES 2: Lista e aktiviteteve në klasë për promovimin e mirëqenies dhe rritjen e sigurisë

Punëtorja 1: Dil n'këpucat e tij/saj

Tema: Parandalimi i dhunës

Qëllimi i punëtorisë: Qëllimi i kësaj punëtorie është të ndërgjegjësojë në lidhje me dhunën brenda klasës, dhe të u mësojë të bashkëndejnë.

Lehtësues/it: Psikologu i Shkollës

Pjesëmarrës: nxënësit dhe mësimitdhënësit

Metodologjia: punë në grupe (me 3 grupe, nga 5 nxënës)

Përgatitja

Lehtësuesit i përgatisin materialet e nevojshme dhe u shpjegojnë pjesëmarrësve qëllimin dhe metodologjinë e punëtorisë. Më pas, ata i ndajnë të pranishmit në tri grupe.

Materialet e nevojshme:

- Letra, lapsa, flip charts
- 2 fotografi ku paraqiten bullizmi dhe empatia

Konkluzioni

Në fund të punëtorisë, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të identifikojnë dhunën dhe bullizmin, dhe të bashkëndejnë me të gjitha personazhet e një situatë të dhunshme. Ata duhet të mësojnë se çka është empatia dhe si praktikohet në këto lloj situatash.

Zhvillimi

1. Shpërndahet një foto (me tri elemente: të bullizuarin, bullizuesin dhe "vëzhguesit"), dhe kërkohet nga pjesëmarrësit të identifikojnë personazhet dhe të diskutojnë në grup për situatën. (4-5min)
2. Lehtësuesit prezantojnë një foto tjetër (me dy elemente: këpucë dhe figurë që ilustron bashkëndejnjen). (1-2min)
3. Lehtësuesit u ndajnë grupeve nga një personazh nga foto e parë dhe i udhëzojnë që të bashkëndejnë dhe përshkruajnë duke "dalë në këpucët e tij". (10min)
4. Secili grup prezanton përshkrimet e tyre dhe si ata u ndjenë duke përshkruar situatën. (10-15min)
5. Lehtësuesit hapin diskutime për një nga këto tema, varësisht nga çështja që kanë për qëllim të trajtojnë:
 - "Si të identifikojmë dhe parandalojmë dhunën?"
 - "Si të raportojmë dhunën?"
 - "Trajtimi i dhunës në shkollë."

Punëtorja 2: Wrinkled Wanda

Tema: Parandalimi dhe identifikimi i dhunës

Qëllimi i punëtorisë: Qëllimi i kësaj punëtorie është të mësojë identifikimin e dhunës dhe ndërgjegjësimin mbi bullizmin verbal.

Lehtësues/it: Psikologu i Shkollës

Pjesëmarrës: nxënësit, mësime dhënësit

Metodologjia: punë grupore (pa ndarje, maksimumi 30 nxënës)

Përgatitja

Lehtësuesit i përgatisin materialet e nevojshme dhe u shpjegojnë pjesëmarrësve qëllimin dhe metodologjinë e punëtorisë.

Materialet e nevojshme:

- Letra, lapsa, flip charts

Konkluzioni

Në fund të punëtorisë pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të identifikojnë dhunën dhe të dinë se çka është bullizmin verbal. Ata duhet gjithashtu të jenë në gjendje të dallojnë fjalët fyese që mund të lëndojnë një person.

Zhvillimi

1. Lehtësuesit vizatojnë në flip chart një trup të plotë të një personi, pa karakteristika gjinore, të cilin e emërtojnë Wanda apo me ndonjë emër tjetër, të cilin e shohin më të përshtatshëm.
(2min)
2. Më pas, lehtësuesit ftojnë pjesëmarrësit që të shkruajnë fyerje/ofendime të ndryshme kundrejt personit, të cilat mendojnë se do ta lëndojnë atë (në fillim pjesëmarrësit mund të hezitojnë, por është e rëndësishme që ju t'i nxisni të tregohen realistë).
(7min)
3. Pasi pjesëmarrësit "fyejnë" Wandën, lehtësuesit e rrudhosin flip chartin, dhe ua japin nxënësve që të mundohen ta kthejnë në gjendjen e mëparshme.
(5min)
4. Pjesëmarrësit diskutojnë mbi pamundësinë e Wandës për t'u rikthyer në gjendjen e mëparshme, pasi është fyer e thyer nga ofendimet. Ata diskutojnë për peshën dhe ndikimin që kanë ofendimet/fyerjet.
(20min)

Punëtorja 3: Delikuenca

Tema: Parandalimi dhe identifikimi i dhunës

Qëllimi i punëtorisë: Kjo punëtori për qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve për parandalimin e sjelljeve delikuede, si dhe ndërlidhjen e tyre me dhunën.

Lehtësues/it: Psikologu i Shkollës, mësimdhënësit

Pjesëmarrës: nxënësit

Metodologjia: punë në grupe (5 grupe)

Përgatitja

Lehtësuesit i përgatisin materialet e nevojshme dhe u shpjegojnë pjesëmarrësve qëllimin dhe metodologjinë e punëtorisë. Më pas, ata i ndajnë të pranishmit në grupe.

Materialet e nevojshme:

- Letra, lapsa, flip charts
- Tiketa me elemente të delikuecës (gjenden në Shtojcën 1)

Konkluzioni

Pas kësaj punëtorie, nxënësit duhet të jenë në gjendje të identifikojnë dukuritë delikuede, dhe të dinë për masat që duhet marrë para se delikuenca të shndërrohet në dhunë. Në fund, si konkluzion shihet qasja e fëmijëve ndaj kësaj çështjeje.

Zhvillimi

1. Lehtësuesit u kërkojnë nxënësve të shprehin opinionet e tyre në lidhje me termin "delikuecë", duke potencuar nëse kuptojnë apo jo domethënien e këtij termi. (5min)
2. Lehtësuesit shpjegojnë në lidhje me delikuecën; ata sqarojnë se ajo është një seri sjelljesh të papërshtatshme antisociale, të cilat mund të përfundojnë në dhunë. (5min)
3. Nxënësit ndahen në pesë grupe dhe secilit grup i shpërndahet nga një tiketë:
 - Tiketa 1: *Nxënësi që shoqërohet me grupe të pasjellshme;*
 - Tiketa 2: *Një nxënës çdo ditë vjedh gjëra të imta;*
 - Tiketa 3: *Djali dhe vajza që përdorin substanca narkotike/psikoaktive;*
 - Tiketa 4: *Ai dhe ajo ikin nga ora dhe i gënjejnë prindërit dhe mësimdhënësit e tyre;*
 - Tiketa 5: *Ata po ngucen dhe po rrahen çdo ditë pas orëve mësimore. [shihni në shtojcë] (3min)*
4. Nxënësit diskutojnë në grupe se si mund të zgjidhen problemet që kanë në tiketat e tyre. (10min)
5. Një tabelë prezantohet nga lehtësuesit dhe plotësohet nga nxënësit e secilit grup. [tabela gjendet në Shtojcën 1] (10min)

Punëtorja 4: Pak, mesatarisht a shumë?

Tema: Raportimi i dhunës

Qëllimi i punëtorisë: Kjo punëtori ka për qëllim të ngrejë njohuritë e pjesëmarrësve për vlerësimin e reagimit në proporcion me situatën dhe të nxjerrë metoda dhe instrumente për raportim të dhunës, në dobi të shkollës.

Lehtësues/it: Psikologu i Shkollës

Pjesëmarrës: nxënësit, mësime dhënësit

Metodologjia: punë në grupe homogjene

Përgatitja

Lehtësuesit i përgatisin materialet e nevojshme dhe u shpjegojnë pjesëmarrësve qëllimin dhe metodologjinë e punëtorisë. Më pas, ata i ndajnë të pranishmit në grupe.

Materialet e nevojshme:

- Letra, lapsa, flip charts
- Shirit ngjitës

Konkluzioni

Në fund të kësaj punëtorie duhet të nxirren disa mënyra për ndërtimin e mekanizmave raportues të dhunës në shkollë.

Zhvillimi

1. Lehtësuesit vendosin në tokë një shirit të gjatë, të ndarë në tri pjesë me mbishkrimet “pak”, “mesatarisht” dhe “shumë” [shih formën në Shtojcën 1].
(3min)
2. Kërkohet nga pjesëmarrësit që të tregohen të sinqertë dhe të ndajnë me të tjerët situata dhune ku kanë qenë dëshmitarë. Shiriti do të përdoret nga pjesëmarrësit për të vlerësuar se sa e dhunshme ka qenë situata sipas tyre.
(20min)
3. Pjesëmarrësit ndahen në grupe dhe u kërkohet të shkruajnë pesë veprime që do të ndërmerrnin në rast se do të ishin dëshmitarë të dhunës.
(10min)
4. Nxënësit diskutojnë në grupe se si mund të zgjidhen problemet që kanë në tiketat e tyre.
(10min)
5. Secili grup i prezanton veprimet e veta dhe bashkë përmbledhin 5, të cilat ata vlerësojnë se janë më të mirat apo më të përshtatshmet.
(15min)

Punëtorja 5: Pengesat

Tema: Raportimi i dhunës

Qëllimi i punëtorisë: Qëllimi i kësaj punëtorie është të identifikohen pengesat në të cilat nxënësit hasin në rast se duan të raportojnë dhunën.

Lehtësues/it: Psikologu i Shkollës, mësimdhënësit

Pjesëmarrës: nxënësit

Metodologjia: punë në grupe (me 5 grupe)

Përgatitja

Lehtësuesit i përgatisin materialet e nevojshme dhe u shpjegojnë pjesëmarrësve qëllimin dhe metodologjinë e punëtorisë.

Materialet e nevojshme:

- Letra, lapsa, flip charts

Konkluzioni

Në fund të kësaj punëtorie, menaxherët e projektit do ta kenë të qartë se cilat janë pengesat që nxënësit e shkollës përkatëse hasin në raportim, do jenë në gjendje të shohin këndvështrimin e nxënësve sa i përket evitimit të atyre pengesave.

Zhvillimi

1. Lehtësuesit i udhëzojnë nxënësit të shkruajnë në letër nga një pengesë/arsye, e cila do t'i pengonte në rast se do donin të raportnin një situatë dhune dhe t'i shpërndajnë në dysheme [pengesat e njëjta apo të ngjashme shkrihen në një].
(5min)
2. Secili nxënës shkon dhe i shënjon me + tri pengesa tjera, përveç asaj që ka shkruar vetë, që sipas tij/saj janë më relevante.
(10min)
3. Më pas, përmbledhen 5 pengesat me më së shumti shenja, dhe nxënësit ndahen në 5 grupe.
(5min)
4. Secili grup trajton një nga pesë pengesat, dhe diskutojnë e shkruajnë në lidhje me zgjidhjet potenciale të atyre pengesave.
(20min)
5. Secili grup prezanton idetë e veta.
(10min)

Punëtorja 6: Nënvizio dhe reflekto

Tema: Trajtimi i dhunës

Qëllimi i punëtorisë: Kjo punëtori ka për qëllim të nxisë te nxënësit mendimin kritik sa i përket dhunës apo bullizmit të paqëllimshëm dhe reflektimin mbi të.

Lehtësues/it: Psikologu i Shkollës

Pjesëmarrës: nxënësit

Metodologjia: punë grupore (pa ndarje, maksimumi 20 pjesëmarrës)

Përgatitja

Lehtësuesit i përgatisin materialet e nevojshme dhe u shpjegojnë pjesëmarrësve qëllimin dhe metodologjinë e punëtorisë.

Materialet e nevojshme:

- Letra, lapsa, flip charts
- Artikull përshkruar mbi bullizmin [gjendet në Shtojcën 1]

Konkluzioni

Në fund të kësaj punëtorie, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të identifikojnë nëse ndonjëherë kanë ushtruar bullizëm jo qëllimisht dhe të reflektojnë në këtë aspekt.

Zhvillimi

1. Lehtësuesit u shpërndajnë pjesëmarrësve nga një artikull përshkruar mbi bullizmin [shih në shtojcë] dhe u japin udhëzime. (5min)
2. Pjesëmarrësit e lexojnë me kujdes artikullin dhe nënvizojnë elementet të cilat mendojnë se i kanë bërë apo parë ndonjëherë në shkollë. (10min)
3. Më pas, në format rrethor ata diskutojnë dhe reflektojnë mbi ato që kanë nënvizuar. (5min)
4. Në fund, pjesëmarrësit shkruajnë në flip charts disa gjëra për të cilat të gjithë duhen të kenë kujdes në jetën e përditshme, në mënyrë që të mos bullizojnë pa vetëdije. (20min)

Punëtorja 7: Kutia empatike

Tema: Trajtimi i dhunës

Qëllimi i punëtorisë: Qëllimi i kësaj punëtorie është të nxisë bashkëndjën/empatinë te nxënësit, në mënyrë që të trajtohen plagët e dhunës.

Lehtësues/it: Psikologu i Shkollës

Pjesëmarrës: nxënësit, mësime/mësuesit

Metodologjia: punë grupore (pa ndarje, maksimumi 25 pjesëmarrës)

Përgatitja

Lehtësuesit i përgatisin materialet e nevojshme dhe u shpjegojnë pjesëmarrësve qëllimin dhe metodologjinë e punëtorisë.

Materialet e nevojshme:

- Letra, lapsa, flip charts
- Dy kuti
- Ngjitës

Konkluzioni

Në fund të punëtorisë, pjesëmarrësit duhet të ndihen më mirë, pasi kanë ndarë historitë e tyre që lidhen me bullizmin. Ata duhet të jenë në gjendje të dallojnë elementet që kanë bërë personat e ndikuar nga bullizmi të ndihen keq.

Zhvillimi

1. Lehtësuesit vendosin në mes të sallës 2 kuti, me mbishkrimet "Bullizova" dhe "Më bullizuan".
(3min)
2. Më pas, lehtësuesit iu shpërndajnë pjesëmarrësve nga dy letra, në të cilat do të shkruajnë një moment ku janë ndjerë të bullizuar dhe një moment kur kanë bullizuar dikë, në mënyrë anonime.
(10min)
3. Pasi letrat të jenë dorëzuar në kuti, lehtësuesit i përziejnë ato dhe i udhëzojnë pjesëmarrësit që me rradhë të shkojnë dhe të marrin nga një letër nga të dy kutitë dhe t'i vendosin ato në mur (në një pjesë të murit letrat e njëjës kuti, dhe në një tjetër të kutisë tjetër).
(5min)
4. Të gjithë i shikojnë dhe lexojnë letrat e vendosura në mur. Ata zgjedhin një që u lë më shumë përshtypje dhe e marrin me vete.
(20min)
5. Pjesëmarrësit kthehen në vend, lexojnë letrat që kanë marrë me vete dhe diskutojnë në lidhje me to.
(15min)

SHTOJCA 1: Materiale ndihmëse për realizimin e Aneksit 2

Akullthyes (ice-breakers) për t'i përdorur në fillim të punëtorive

"Hedhja e emrit"

- Secili pjesëmarrës shkruan emrin e tij dhe një fakt interesant për veten në fletë dhe e grumbullon atë në një top.
- Kur të gjithë pjesëmarrësit të kenë topat e tyre prej letre, kërkojuni t'i hedhin përpara dhe mbrapa nëpër dhomë.
- Lehtësuesi më pas bërtet, "Stop!" dhe çdo pjesëmarrës merr një top letre, e hap atë dhe e lexon në heshtje.
- Vëri pjesëmarrësit t'i lexojnë grupit secilën letër me radhë dhe të prezantojnë personin, letrën e të cilit mbajnë. Vazhdoni për të gjithë grupin e pjesëmarrësve.

"Dy t'vërteta e një rrenë"

- Ulini pjesëmarrësit në rreth dhe kërkojuni të prezantojnë veten me dy të vërteta dhe një gënjeshtër (e cila tingëllon e besueshme).
- Kërkojuni pjesëmarrësve tjerë që të qëllojnë se cila është gënjeshtër.
- Kur dikush e qëllon gënjeshtërën, vazhdohet derisa të gjithë pjesëmarrësit prezantojnë veten.

"Mbiemër me shkronjën e parë të emrit"

- Ulini pjesëmarrësit në rreth dhe duke filluar nga ana e djathtë kërkojuni të prezantojnë veten duke vendosur para emrit të tyre një mbiemër i cili fillon me shkronjën e parë të emrit të tyre. (p.sh.: Sara → super-Sara, Jetmir → jetëgjati Jetmir).
- Me radhë, secili duhet të përsërisë emrat dhe mbiemrat e të gjithë folësve paraprak, dhe më pas të vazhdojë me veten.

Punëtorja 3: Tiketatat me elemente të delikuencës



TIKETA 1: Nxënësi që shoqërohet me grupe të pasjellshme



TIKETA 2: Një nxënës që çdo ditë vjedhë gjëra të imëta



TIKETA 3: Djali dhe vajza që çdo ditë përdorin substanca narkotike/psikoaktive



TIKETA 4: Djali dhe vajza që ikin nga ora dhe gënjejnë prindërit dhe mësuesin e tyre




TIKETA 5: Ata ngucen dhe rrahen çdo ditë pas orëve të mësimit



Punëtorja 3: Tabela e tiketave

<i>Rastet sipas tiketave</i>	<i>Kush njoftohet fillimisht?</i>	<i>Cili është roli i familjes?</i>	<i>Cili është roli i shkollës?</i>	<i>Cili është roli i nxënësve?</i>	<i>Ku raportohet rasti pas shkollës dhe pse?</i>	<i>Cilat institucione tjera janë përgjegjëse për trajtimin adekuat të këtyre rasteve?</i>
Tiketa 1						
Tiketa 2						
Tiketa 3						
Tiketa 4						
Tiketa 5						

Punëtorja 4: Forma e shiritit vlerësues





Çfarë është bullizmi? *Burimi: stopbullying.gov*

Bullizmi është sjellje e padëshiruar, agresive midis fëmijëve të moshës shkollore, që përfshin një çekuilibër të vërtetë ose të perceptuar të fuqisë; Sjellja përsëritet, ose ka potencialin të përsëritet, me kalimin e kohës. Të dy, fëmijët që bullizohen dhe që bullizojnë të tjerët mund të kenë probleme serioze dhe të gjata.

Në mënyrë që të konsiderohet bullizëm, sjellja duhet të jetë agresive dhe të përfshijë:

- **Një çekuilibër të fuqisë:** Fëmijët që bullizojnë përdorin fuqinë e tyre, të tilla si forca fizike, aksesin në informacione të turpshme ose popullaritet; për të kontrolluar ose dëmtuar të tjerët. Mosbalancimet e pushtetit mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në situata të ndryshme, edhe nëse përfshijnë të njëjtët njerëz.
- **Përsëritje:** Sjelljet bullizuese ndodhin më shumë se një herë ose kanë potencialin të ndodhin më shumë se një herë.

Bullizmi përfshin veprime të tilla si kërcënimet, përhapja e thashethemeve, sulmi fizik ose verbal i dikujt dhe përgjashtimi i dikujt nga një grup me qëllim.

Ekzistojnë tri lloje të bullizmit:

- **Bullizmi verbal** është të thuash ose të shkruash gjëra të liga/këqija. Bullizmi verbal përfshin:
 - Ngacim;
 - Thirrje në emra;
 - Komente të papërshtatshme seksuale;
 - Tallje;
 - Kërcënim për të lënduar.
- **Bullizmi social/shoqëror**, i referuar ndonjëherë si bullizëm relational, përfshin dëmtimin e reputacionit ose marrëdhënieve të dikujt. Bullizmi social përfshin:
 - Përgjashtimi/mospërfshirja e dikujt me qëllim;
 - T'u thuash fëmijëve të tjerë të mos jenë shokë me dikë;
 - Përhapja e thashethemeve për dikë;
 - Të turpërosh dikë në publik.
- **Bullizmi fizik** përfshin lëndimin e trupit ose zotërimeve materiale të një personi. Bullizmi fizik përfshin:
 - Goditje/shkelm;
 - Pështyrë;
 - Shtyrje;
 - Marrja ose thyerja e gjërave të dikujt;
 - Bërja e gjesteve të këqija ose të pasjellshme me duar.

